



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

Legjislatura VI  
Komisioni për Buxhet dhe Financa  
Mbledhja nr. 52/19  
Prishtinë, më 14.05.2019, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

**PROCESVERBAL**

Në mbledhjen e Komisionit: Lumir Abdixhiku, Safete Hadergjonaj, Arbërie Nagavci, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Blerim Kuçi, Ali Lajçi dhe Fikrim Damka.

Munguan: Jelena Bontic, Dardan Molliçaj dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Fatmir Gashi – Zëvendësministër i Financave dhe Ahmet Ismaili – Drejtor i Departamentit të Thesarit në Ministrinë e Financave.

Pjesëmarrës tjerë: Artan Murati-Menaxher nga KDI; Marigona Berisha-Asistente-GP LDK; Arbelina Dedushaj-Hulumtuese- D+; Mexhid Tumiqi-SVK; Nora Kelmendi-Gazetare nga Ekonomia Online, Sanie Jusufi-Gazetare nga Koha Ditore, Majlinda Jashanica-Asistente/Hulumtuese-Aktiv.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Luljeta Krasniqi, Sabrije Iseini , Dashurije Canolli, Sofie Tahiri- Praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku, Kryetari i Komisionit (tutje Kryetari).

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 24.04.2019;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Financimin e Projektit për Kadastër të Patundshmërisë dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2019;**
- 5. Shqyrtimi i Kërkesës nr.00255/19/shs, dt. 11 Mars 2019 të Drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e lartësisë së koeficientit dhe të pagës së Drejtorit dhe Zëvendës-Drejtorit të kësaj Agjencie;**
- 6. Shqyrtimi i kërkesës se Anëtareve te Komisionit për Ndihmë Shtetërorë për sigurimin e hapësirës dhe buxhetit për vitin 2019;**
- 7. Të ndryshme.**

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari:** Sekretari i Kuvendit ka njoftuar se është jashtë vendit, propozojë që pika katërt e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e parë 2019, të shtyhet për një mbledhje tjetër të Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni me 7 vota Për, 1 votë Abstenim dhe Ansjë votë Kundër, miratoi rendin e ditës me ndryshime: pika e katërt e rendit të ditës, shtyhet për një mbledhje tjetër të Komisionit.

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 24.04.2019**

**Kryetari:** Konstatoi se Komisioni unanimisht, miratoi procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 24.04.2019, pa ndryshime.

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Financimin e Projektit për Kadastër të Patundshmërisë dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim**

**Kryetari:** Ja kaloi fjalën zv.ministrit të financave për të paraqitur dhe arsyetuar marrëveshjen.

**Fatmir Gashi:** Qëllimi i marrëveshjes është shumëdimensional ku përmes saj synohet të arrihen objektiva si rritja e cilësisë dhe investimit stë tokës, të dhënave, rritja e transparencës, rindërtimi i kadastrave etj, përmes avancimit të platformave të ndryshme duke kontribuar kështu në ekonominë e vendit. Ndër elementet kyqe të projektit janë edhe modernizimi i kadastrës. Në bazë të kushteve të marrëveshjes financiare kredia është në vlerë prej 14.6 milion euro me normë interesi vjetor 1,35% dhe do të arrijë zotimin prej 0,5% që bënë të jetë kredi mjaft e volitshme. Periudha e kthimit të kredisë është 30 vjet.

**Kryetari:** Në parim i mbështesim marrëveshjet e till dhe kjo është një marrëveshje afatgjate dhe me kushte të volitshme të kredisë. Më pas e hodhi në votim miratimin e Projektligjit.

Pas përfundimit të diskutimeve, në bazë të propozimit dhe votimit, Kryetari konstatoi se Komisioni me 7 vota Për, 1 votë Abstenim dhe Asnjë votë Kundër, nxori këtë

### **Rekomandim**

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin nr.06/L-157 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Financimin e Projektit për Kadastër të Patundshmërisë dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

## **4. Shqyrtimi i Kërkesës nr.00255/19/shs, dt. 11 Mars 2019 të Drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjensisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e lartësisë së koeficientit të pagës së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të kësaj Agjensie**

**Kryetari:** Propozim për formimin e një grupi punues që të analizojë kërkesën dhe pastaj të bëjë raportin me rekomandime për komisionin.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht caktojë Grupin Punues në përbërjes prej: Mërgim Lushtaku (kryesues), Blerim Kuçi dhe Fikrim Damaka – anëtar, për shqyrtimin e Kërkesës për caktimin e pagës së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Agjensisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës. Grupi Punues paraqet raportin me rekomandime për shqyrtim në Komision.

## **5. Shqyrtimi i kërkesës së Antarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore për sigurimin e hapësirës dhe buxhetit për vitin 2019**

**Kryetari:** Komisioni për Ndihmë Shtetërore ka rol të rëndësishëm në implementimin e ndihmës shtetërore, sepse puna e tij ndërlidhet edhe me zbatimin e MSA-së. Anëtarët e Komisionit janë emëruar dhe nuk i kemi krijuar as hapësira për punë e as buxhet, ka njëfarë moskuptimi mes Kuvendit dhe Ministrisë së Financave se ku duhet vendosur. Departamenti për ndihmë shtetërore gjendet në Ministri të Financave, ndërsa anëtarët e Komisionit janë të zgjedhurit nga Kuvendi.

**Naser Osmani:** Pjesa ekzekutive është pranë Ministrisë së Financave, ndërsa Komisioni është dashur të jetë e vendosur në Kuvend, për momentin nuk gjendet askund. Unë propozojë që t’ia dërgojmë një shkresë Ministrisë së Financave, që të ndaj buxhet dhe krijimin e kushteve elementare për punë për Komisionin. Komisioni ka bërë një planifikim të shpenzimeve për muajt maj-dhjetor 2019, ne i’a dërgojmë Ministrit të bashkangjitur kërkesën e Komisionit për Ndihmë Shtetërore, me përjashtim të stafit mbështetës dhe kërkesës për blerjen e veturës. Një kërkesë duhet t’i dërgohet Ministrisë së Administratës Publike, që të ofrojë një veturë zyrtare ekzistuese për Komisionin. Procedura për transferin e buxhetit kalon fillimisht në buxhet të Kuvendit i cili pastaj i’a përcjell paratë Komisionit.

**Safete Hadergjonaj:** Është shqetësuese kur i formojmë institucionet dhe nuk e dimë se ku duhet të pozicionohen. Ne kemi pasur vërejtje edhe në Raportet e Progresit të Komisionit Evropian në lidhje me funksionimin e institucioneve të tilla të pavarura. Ne gjatë hartimit të buxhetit e kemi ditur për këtë komision dhe kemi përcaktuar pagat në kuadër të buxhetit të Kuvendit, mirë nuk është ndarë buxhet tjerë për funksionimin e tij. Sa i përket procedurave të ndarjes së buxhetit jemi në një kohë që nuk ka ndryshime të buxhetit megjithatë unë jam e bindur se Ministri i Financave ka pajtueshmëri për ndarjen e mjeteve dhe ne duhet të gjejmë formen se si ti qasemi ndarjes apo transferit të buxhetit për këtë komision. Do të ishte mirë që Sekretari të sigurojë hapësira për punë brenda Kuvendit.

**Fatmir Gashi:** Theksoi se edhe në takimet që ka pasur me zyrtarët e BE-së është përmendur nevoja për funksionalizimin e këtij Komisioni. Ne në buxhet kemi propozuar vetëm paga ndërsa sa i përket shpenzimeve për kategoritë tjera duhet të shikojmë të bëhet akomodimi prej buxhetit të Kuvendit. Ministria e Financave në momentin që pranojmë kërkesën, do ta shqyrtojmë me interes.

Kryetari konstatoi se Komision unanimitisht vendosi që ti dërgojë një shkresë Ministrisë së Financave një shkresë për ndarjen e buxhetit për Komisionin për Ndihmë Shtetërore dhe një kërkesë tjerë për Ministrinë e Administratës Publike për sigurimin e një veture ekzistuese për këtë komision.

## **7. Të ndryshme**

**Arbërie Nagavci:** Siç jemi në dijeni në bazë të Ligjit për ndalimin e lojërave të fatit, është ndaluar edhe aktiviteti i Lotarisë së Kosovës. Ndërmarrja Publike Lotaria e Kosovës është në situatë jo të mirë. Mbi 60 punëtorë rrezikohen të mbesin pa punë. Përfaqësuesit e Lotarisë kanë zhvilluar takime me të gjitha grupet parlamentare lidhur me hartimin e Projektligjit të Lotarisë së Kosovës. Jam në dijeni me shkresën tuaj kryetar që keni kërkuar nga Qeveria dhe Ministria e Financave që të hartojnë Projektligjin, por deri

me tani nuk është ndërmarrë ndonjë iniciativë e tillë. Unë propozoj që në mbledhjen e radhës t'i ftojme përfaqësuesit e Lotarisë së Kosovës dhe ti dëgjojmë për këtë çështje në komision.

**Kryetari:** Sa i përket Lotarisë së Kosovës, ne kemi kërkuar që Qeveria dhe Ministria e Financave të hartojnë projektligjin sepse kanë kapacitetet dhe ekspertizën, ndërsa në momentin që procedohet Projektligji në Kuvend ne si komision funksional jemi të gatshëm ta procedojmë me procedurë të përshpejtuar. Por, unë mendoj se Komisioni nuk ka ekspertizë për ta hartuar një projektligji të tillë. Ne mund ti takojmë përfaqësuesit e Lotarisë, por adresa për hartimin e Projektligjit është në Qeveri.

**Blerim Kuçi:** Nuk është problem me i dëgju përfaqësuesit e Lotarisë, por nëse organizojmë një takim të tillë mos po krijojmë hapësirë edhe për grupet tjera për takime të tilla, kur ne si komision nuk po marrim iniciativën për hartimin e projektligjit.

**Naser Osmani:** Ne nuk kemi asnjë dokument përpara për të dëgjuar pastaj përfaqësuesit e lotarisë. Hartimi i Projektligjit të Lotarisë është përgjegjësi e Qeverisë. Komisioni mund të organizojë takime pasiqë Projektligji të procedohet në Kuvend.

**Safete Hadergjonaj:** Meqë hartimi i Projektligjit për Lotarinë e Kosovës ka mbetur që të hartohet nga Qeveria, unë mendoj që Komisioni mund të organizojë takimin me përfaqësuesit e lotarisë dhe subjektet tjera, pasi që Qeveria të procedojë Projektligjin në Kuvend.

Kryetari konstatoi se Komisioni me 2 vota Për, 1 votë Kundër dhe 3 vota Abstenim, nuk miratojë propozimin e deputetes Arbërie Nagavci, që në mbledhjen e radhës të ftohen përfaqësuesit e Lotarisë së Kosovës për të diskutuar lidhur me hartimin e Projektligjit për Lotarinë e Kosovës.

**Safete Hadergjonaj:** Theksoi se në mandatin e kaluar kemi bërë monitorimin e Ligjit për Partneritet të Publiko Privat. Ka qenë i hartuar dhe miratuar raporti nga komisioni në bazë të gjeturve, mirëpo për shkak se Kuvendi ka ndërprerë punimet, raporti ka mbetur i pamiratuar. Propozoj të formohet një Grup Punues nga Komisioni që të analizojë të gjeturat dhe ti bëjë edhe disa takime tjera dhe ta dërgojnë raportin në Kuvend për miratim.

Kryetari konstatoi se Komisioni caktoi Grupin Punues në përbërje prej: Safete Hadergjonaj (kryesuese), Mërgim Lushtaku dhe Everi Hoti për të analizuar Raportin me rekomandime të Komisionit nga mandati i kaluar V, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Partneritet Publiko Privat, për të bërë takime të nevojshme me subjektet të caktuar dhe për të përgaditur raportin me rekomandime për shqyrtim në Komision.

**Mbledhja përfundoi në orën 10:35**  
**Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit**

**Kryetari i Komisionit,**

-----  
**Lumir Abdixhiku**